

Mishelatori - Ushqimi të përziejhet, jo të shtypet

Përgatitur nga Franz Riegler, konsulent i Schaumann dhe aksioner i Austria Prämix shpk.



Përdorimi i mishelatorit ka shumë përparësi, por fsheh edhe shumë disavantazhe. Përzierja për një kohë të gjatë ose numri i pamjaftueshëm i thikave çon në shkatërrimin e strukturës së ushqimit. Por çfarë duhet patur parasysh gjatë blerjes dhe vënies në punë të mishelatorit, tregohet në artikullin e mëposhtëm!

Një racion i përzier, ka një përmbajtje prej 40 - 50% të lëndës së thatë. Bari duhet të jetë i prerë, i përzier mirë, por jo i shtypur. Përzierja për një kohë të gjatë dhe pamjaftueshmeria e thikave prerëse, shkatërrojnë strukturën e barit, e cila shkakton acidozën e plëndësit, përçindje të ulët të yndyrës në qumësht dhe vuajtje me thundrat. Vetëm kur bari është i prerë mirë dhe jo i shtypur ruhet struktura e duhur. Thikat duhet të mprehen rregullisht ose të zëvendësohen. Pas prerjes, pjesët e kërcellit duhet të preken me dorë dhe rreth 1/5 e ushqimit duhet të jetë sa gjatësia e gishtit. Vetëm kështu racioni i përzierë është ai i duhuri.

2 herë në ditë

Nëse ka mangësi në strukturë, atëherë racioni duhet të zëvendësohet me bar të thatë, kashtë ose jonxhë të thatë. Fryrja e një racioni ushqimor të varfër mund të zhduk aciditetin e lartë në stomak. Humbje të larta të vlerës ushqyese dhe lëndës së thatë hasen kur racioni i përzier ngrohet. Rregulli universal është: ngrohje 10°C do të thotë 10% humbje energjie. Prandaj ia vlen që në verë ose për silazhet kritike të hidhet dy herë në ditë përzierje e freskët. Përpara se të merret në përdorim një mishelator, përveç krijimit të racionit ushqimor, duhet të analizohet puna dhe vlera financiare e fermës.

Situata operative ndikon ndjeshëm në përdorimin e efektshëm si dhe zgjedhjen e duhur të mishelatorit. Pyetjet e mëposhtme janë vendimtare:

- Si mbushet një mishelator i tërhequr me makineri bujqësore?
- Si magazinohet ushqimi?
- A kemi në dispozicion makineritë e mbushjes, si për shembull një traktor me kovë ose freza silazhi, apo është i nevojshëm një mishelator vetëmbushës?

Vetë-mbushja

Dallohen dy sisteme përzierje: Përzierje spirale (në këmbë dhe shtrirë) si dhe përzierje me rrjedhje të lirë (përzierje me lopata dhe turbina). Këto sisteme ndryshojnë krahas parimit të përzierjes edhe nga mënyra e aplikimit të komponentëve (balla bari rrethore dhe katrore), rreziku i mykut, shfrytëzimi i vëllimit, kërkesa për hapsirë dhe veçori të tjera (përhapja e kashtës). Mishelatorët vetëmbushës me freza ose thika prerëse janë më të shtrenjtë dhe kërkojnë më shumë mirëmbajtje. Gjithashtu, këta mishelatorë duhet të merren në përputhje me stallën, domethënë të përlllogaritet hyrja dhe dalja e lirshme në stallë, lartësia e derës, gjerësia e saj dhe shkarkimi i silazhit. Në procesin e të ushqyerit kanë rëndësi të veçantë, sasia e komponentëve në numër si dhe racioni ushqimor total për një rendiment maksimal qumështi. Sasia e ushqimit duhet të jetë e përshtatshme për mishelatorët. Eventualisht është më i arsyeshëm ndryshimi i racionit sesa të mekanizohet ushqyerja ekzistuese.

Për zgjedhjen përfundimtare të mishelatorit është vendimtare, përveç pajisjeve shtesë (si peshorja) dhe vëllimi i nevojshëm (5 deri në 7 GVE/ m³) veçanërisht disponueshmëria e pjesëve të këmbimit dhe shërbimi i mirë.